

Qarku Lezhë **Lezha Region**
Gjurmë Traces
dhe Horizonte and horizons

2011

QARKU LEZHË, GJURMË DHE HORIZONTE

Autoret e teksteve

Gjergj Shyti
Halit Kavaja
Viktor Gjokolaj
Vlash Prendi
Ndue Dedaj
Cezar Rica
Linda Maçi
Jak Gjini
Gjovalin Gjeloshi
Pjetër Marku

Redaktor

Gjergj Shyti
Viktor Gjokolaj

Fotografitë

Pjetër Marku
Jak Gjini
Gjovalin Gjeloshi
Preng Gjokolaj
Linda Maçi

U shfrytëzuan gjithashtu nga fondi i
Fototekës së Muzeut Historik Mirditë, Lezhë,
Pallateve të kulturës Lezhe, Kurbin, Mirditë.

Përkthyes

Arbana Dibra

Projektoi

Djana Bejko

Koordinatorë e projektit

Linda Maçi

Drejtoi Projektin dhe përgatiti për botim

Mbështeti : Agjencia Zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim,
Programi për decentralizimin dhe Zhvillimin Lokal në rajonet e
Shkodrës dhe Lezhës (PDZHL II) dhe Këshilli i Qarkut Lezhë

LEZHA REGION, TRACES AND HORIZONS

Text authors

Gjergj Shyti
Halit Kavaja
Viktor Gjokolaj
Vlash Prendi
Ndue Dedaj
Cezar Rica
Linda Maçi
Jak Gjini
Gjovalin Gjeloshi
Pjetër Marku

Editors

Gjergj Shyti
Viktor Gjokolaj

Photography

Pjetër Marku
Jak Gjini
Gjovalin Gjeloshi
Preng Gjokolaj
Linda Maçi

Materialse taken from
Phototeque of Historic Museum in Mirdita, Lezhë; Houses of
Culture in Lezhe, Kurbin, Mirditë.

Translator

Arbana Dibra

Projected by

Djana Bejko

Project Coordinator

Linda Maçi

Project Leader and preparation for publication

Supported by: Swiss Agency for Development and Cooperation,
Program for Decentralization and Local Development in the re-
gions of Shkodra and Lezha (dldp II) and the Regional Council
of Lezha



07

01

Hyrje
Introduction



09

02

Gjurmëve të historisë
Along the history traces



37

03

Etnokultura
Ethno culture



65

04

Figura të shquara të kulturës dhe letërsisë
Distinguished figures of culture and literature



79

05

Traditë e realitete urbane dhe infrastrukturore
Urban and infrastructural Traditions and Realities



91

06

Mjedisi dhe turizmi
Tourism and Environment



145

07

Arte dhe Sporte
Arts and Sports

Qarku Lezhë, gjurmë dhe horizonte...

Të nderuar lexues!

Botimi i albumit "Lezha, Gjurmë dhe Horizonte", është një vazhdim i frytshëm i bashkëpunimit me donatorët, aktorët dhe faktorët lokal në udhën e hartimit të politikave rajonale për një zhvillim të qëndrueshëm, të kristalizuara tashmë në një varg dokumentesh strategjik të miratuara nga Këshilli i Qarkut.

Ky botim vjen si produkt i punës së kujdesshme të ekspertëve të fushave të ndryshme me mbështetjen e Programit për Decentralizimin e Zhvillimit Lokal, që financohet nga Kooperacioni Zvicëran (Swiss Cooperation – SDC)

Si një dokument promovues, ky album prezanton vlerat dhe gjurmët e historisë së gjithëkohëshme të këtij territori, i cili për shkak të pozicionit gjeografik identifikohet me shumë ngjarje të një rëndësie të veçantë të historisë kombëtare si: Kuvendi i Lezhës i 2 Marsit 1444 dhe i Arbërit më 1703, etj.

Zbulimi në Ndërfanë i Stemës së Arbërit dhe gurit epigrafit, dëshmojnë për gjurmë të shtetit të parë (1190) dhe përfaqson vlera unike. Qarku i Lezhës përfaqëson territorin e dy monumenteve të traditës: "Kanuni i Lekë Dukagjinit" dhe "Kanuni i Skënderbegut".

Në strukturën e lëndës që po ju paraqesim identifikohen visaret etnokulturore, natyrore, turistike dhe infrastrukturore të rajonit, ku investitorët e huaj dhe vendas do gjejnë adresime të sakta. Në të njëjtën kohë ky album pasqyron traditat kulturore dhe sportive të Rajonit si dhe trashëgiminë e hershme e shkollës shqipe që përfaqësohet përmes personaliteteve e shquara të traditës dhe bashkëkohore që nga Gazullorët e famshëm, Frano Bardhi, leksikografi i parë i gjuhës shqipe, poeti kombëtar Atë Gjergj Fishta e për të vijuar me abatin e Mirditës Prend Doçi, Ambroz Marlaskaj deri tek liriku i njohur Ndoc Gjetja dhe i fundmi i etërve françeskanë, Atë Zef Pllumi. etj.

Një vend të veçantë në këtë album zënë vlerat natyrore dhe peisazhi përfaqësuar nga një numër i madh monumenteve të kulturës dhe monumenteve të natyrës që ndodhen në gjithë territorin e Qarkut të Lezhës dhe që janë përfaqësues të potenciale të mëdha për zhvillimin e turizmit bregdetar, etnokulturor, malor, speleologjik, natyrore dhe ekologjik.

Ky album ilustron përmes fotove dhe informon përmes tekstit respekt dhe emocion për të gjithë ata që kanë lindur dhe kanë kontribuar në krijimin e vlerave në këto vise dhe motivon në mënyrë krijuese sipërmarrjet e tyre për zhvillimin e këtij rajoni.

Njëherësh ky botim pasuron traditën e mirë të veprave promovuese për Qarkun e Lezhës duke u bërë njëherësh "Kartë Identiteti" për këtë rajon.

Përmes këtij adresimi për lexuesin, shpreh mirënjohje dhe falenderim për punën cilësore të ekspertëve që u angazhuan në hartimin e kësaj vepre, e cila do të shërbejë si grishje e bukur për t'i njohur e vizituar këto treva.

Në mënyrë të veçantë falenderoj programin Programin për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal - dldp dhe Kooperacionin Zvicëran (SDC) për mbështetjen financiare dhe asistencën profesionale në hartimin dhe botimin e kësaj vepre.

Pashk Gjoni,
Kryetar i Këshillit të Qarkut Lezhë

Lezha Region, traces and horizons....

Dear Reader!

The publication of the album "Lezha, traces and horizons..." is a continuum of fruitful cooperation among donors, local factors and stakeholders in the way of drafting regional policies for sustainable development, already crystalized approved by the the Regional Council.

This edition comes as a product of the careful work of experts from different fields supported by the Program for Decentralization of Local Development funded by Swiss government.

It is a promoting document which displays intensively the traces throughout the history in this territory which due to its geographic position is identified with important events of national history like: the Lezha Convention of March 2nd in 1444 and the Convention of Arbëri in 1703, etj. The discovery of the Emblem of Arbër in Ndërfanë and of the epigraphic stone which testify for traces of the first albanian state in displaying unique values.

Lezha region is the land of two monuments of custom tradition: "The Canon of Lekë Dukagjinit" and "The Canon of Skënderbeg".

In the content structure that follows are identified the ethnocultural, natural, touristic and infrastructural treasures, of the region with respective addressings for native and foreign investors.

In addition to abovementioned, this album also displays cultural and sports life of the whole region, as well as the ancient tradition of albanian schools. The distinguished personalities of tradition and contemporary times take up top ranking strating with the famous Gazullorë, Frano Bardhi, the first lexicograph of albanian language, national poet Father Gjergj Fishta to continue with the abbot of Mirdita Prend Doçi, Ambroz Marlaskaj until the well known lyric Ndoc Gjetja and the last of the francescan fathers, Father Zef Pllumi, etc.

This album also brings together landscape and the rich colours followed by a big number of culture, natural monuments, which are found all over the territory and comprise a great treasure for the development of tourism of all types: seaside, ethnocultural, mountainous and speleologic. This album provides wide information through traditional and contemporary content and photos unfolding nostalgia and emotion for all those people who were born or have served in these areas, and fosters other enterprises for the development of this region.

At the same time this edition enriches the good tradition of the promoting works not only in Lezha Region.

I take advantage to appreciate the good work done by experts who were engaged in drafting and bringing together parts of this work, which will serve as a nice invitation to get to know and visit these areas.

In particular I thank the Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC) for supporting the project with funding and profesional assistance.

Pashk Gjoni
Chairman of Regional Council of Lezha



Hyrje

01

I ndodhur në pjesën veri-perëndimore të Shqipërisë, rajoni Lezhë-Mirditë-Kurbin zë një sipërfaqe prej 1588,4 kilometrash katrorë me një popullsi prej 218.000 banorë .Nga pikëpamja administrative qarku i Lezhës kufizohet në anën veriore me qarkun e Shkodrës, në lindje e veri-lindje me qarqet e Dibrës e të Kukësit, në jug me atë të Durrësit. Pikat ekstreme: në veri me majën e Kunorës, në jug lumi i Drojës, në perëndim me detin Adriatik. Ka një pozitë të favorshme gjeografike, çka e dëshmojnë lidhjet e hershme me rrugë tokësore e detare, veçanërisht me Shkodrën e bregdetin dalmat si edhe me rajone të tjera në jug. I kompozuar në tre rrethe , Lezha , Mirdita dhe Kurbin ndahet në 21 njësi vendore , 5 Bashki dhe 16 Komuna, me 9 qytete dhe 170 fshatra. Qendra administrative e qarkut është qyteti i Lezhës 2400 vjeçar, i themeluar në vitin 385 p.e.s. Qendra e rrethit Mirditë është qyteti i Rrëshenit , i cili shtrihet në pellgun e Ndërfanës ku bashkohen lumenjtë e Fanit të Madh dhe Fanit të Vogël u shpall qytet në vitin 1949 , ndërsa qendra e rrethit Kurbin është qyteti i Laçit i krijuar në vitin 1959 si qytet i ri industrial .

Rajoni flet për një histori të pasur që në lashtësi. Monumentet e kulturës, objektet e kultit, mbishkrimet, monedhat, emblemat, gjetjet arkeologjike , dokumentet e shkruara si dhe ngjarje e figura të shquara, janë dëshmi domethënëse për të kaluarën e rajonit. Secila prej tri zonave ka të përbashkëta, por dhe tiparet e saj të veçanta të cilat kanë qenë të lidhura me kushtet historike dhe bashkëveprimet të ndërsjellët të këtyre banorëve. Ndodhur në të njëjtat territore, midis tyre pati kurdoherë marrëdhënie ekonomike e tregtare, dokesore e lidhje martesore, kuvende krahinore e kryengritje kundër pushtuesve. Popullsia ka qenë e ndërkallur tek njëra –tjetra mbasi kurdoherë banorë prej trevave malore kanë zbritur me banim në zonat kodrinore e fushore, dukuri që vazhdon edhe në ditët e sotme. Rajoni është gjithashtu konservues e mbartës i mjaft vlerave historike, kulturore, unikale e kombëtare.

Introduction

Situated on the northwestern part of Albania, the region of Lezhe, Mirdita and Kurbin takes up a surface of 1584 km² inhabited by 218000 people. From the administrative point of view Lezha region is bordered with Shkodra region on the northern part, on the north-east with Diber and Kukes region and on the south with Durres region. The extreme points stretch: on the north with the Kunora peak, on the south with Droja river, on the west with Adriatik Sea. It has a favorable geographic position which testify for the ancient connections through land and sea with Shkodra in particular and the Dalmatian coastline as well as other regions further to the south. The region is comprised of three districts: Lezha, Mirdita and Kurbin; is divided into 21 local units, 5 municipalities and 16 communes, 9 cities and 170 villages. The administrative center of the region is Lezha city, which is 2400 years old and was founded in 385 B.C. The center of Mirdita district is Rreshen city announced as such in 1949, situated in the basin of Nderfana, a joint of Fani i Madh and Fani i Vogel rivers, while Laçi the center of Kurbin district was created in 1959 as a new industrial city.

The region displays a rich history since antiquity. The monuments of culture, the objects of cult, the inscriptions, the coins, the emblems, archaeological findings, written documents as well as events and remarkable figures are significant proof of the past of the region. Each of the three areas not only has much in common but also is distinguished by specific features related to historic conditions and reciprocal interaction among the people. Being in the same territories, they have always had economic and commercial relationships; have exchanged marriage and customs relations, regional assemblies and uprisings against the invaders. The region also conserves and transmits many historical, cultural, nationally unique values.

Gjurmëve të historisë

02

Along the history traces

01



02



03



Lezha, në burimet historike të kohës së lashtë përmendet me emrat Lis, Lissos, Lisson, Lissus dhe fthillëzimi i historisë njerëzore në këtë qytet gjallon që në periudhën historike, epokën e bronzit dhe të hekurit. Materiali arkeologjik i zbuluar në Blinisht, Troshan, Spitën, Kallmet e Malësi të Lezhës, flet për një cikël vendbanimesh parahistorike të etnosit ilir. Në bazë të ndryshimeve të rëndësishme që ndodhën në strukturën ekonomiko-shoqërore në Ilirinë jugperëndimore rreth shek.V-VI para Krishtit, zënë fillin e jetës qytetare edhe qendra të tjera në bregdetin lindor të Adriatikut si Shkodra, Rizoni, Ulqini etj. Formën e plotë të një qyteti të zhvilluar Lisi e mori në kohën e përfundimit të sistemit mbrojtës të tij, aty nga fundi i shek.IV ose fillimi i shek III para Krishtit. Ndërtimet mbrojtëse të Lisit ishin sa

të fuqishme për nga konstruksioni dhe teknika e ndërtimit, aq edhe madhështore në pamjen e tyre. Nisur nga ky këndvështrim mund të thuhet se Lisi ishte në radhën e parë të qyteteve më të mbrojtura e më të mëdha të të gjithë Ilirisë dhe sistemi fortifikues i tij ishte ndoshta edhe më i fuqishëm nga ai i Apolonisë.

Lisi funksionon si qytet bregdetar dhe njëkohësisht si limani më jugor i shtetit të Ardianëve. Ai luajti rol me rëndësi sepse shërbente si pikënisje për flotën ushtarake-detare ilire, në sulmet e shpejta e të befasishme kundër qyteteve bregdetare të Adriatikut, Jonit e deri në thellësi të Mesdheut. Qyteti vazhdon të jetë qendër e rëndësishme edhe në kohën e sundimit të mbretëreshës ilire Teuta, e cila sipas burimeve historike

arriti ta organizojë më mirë flotën detare dhe t'i bëjë më të shpeshta operacionet luftarake në mësymjen e qyteteve të tjera të Greqisë. Qyteti i Lisit dhe fortifikimi i tij Akrolisi përmenden për herë të parë në burimet historike nga Polibi, historiani grek i shek.II para Krishtit, i cili në përkthimet e tij u jep hapësirë luftimeve iliro- romake dhe ngjarjeve që u zhvilluan në tokën ilire gjatë luftimeve maqedono-romake ndërmjet viteve 246-146 para Krishtit.

Në vazhdim të ngjarjeve qyteti i Lisit përmendet përsëri nga Polibi, këtë radhë si rezidencë e mbretit Genti, mbret i ilirëve siç quhet ai në burimet historike të kohës së lashtë. Këtu në qytetin e fortifikuar Genti priti delegacionin e parë maqedonas të dërguar nga Perseu për lidhjen e një aleance ndërmjet dy palëve.



01. Sopatë prej guri e periudhes së Neolitit gjetur në Mirditë
Stone axe dating back to the Neolith Period found in Mirdita
02. Lissusi - Akrolissusi
Lissusi Akrolissusi
03. Përkrenare ilire gjetur në Përlat
Illyrian helmet found in Përlat
04. Harta Ilirise
Map of Illyria

Lezha, is mentioned among the ancient history resources by names of Lis, Lissos, Lisson, Lissus and the beginning of the human history in this city dates back in the Bronze and Iron Era. The archaeological material which was discovered in Blinisht, Troshan, Spitën, Kallmet and in Lezha highlands speaks about a series of prehistoric settlements of Illyrian ethnos. Based on the major changes that happened in the economic and social structure of the western Illyria around V-VI centuries B.C we have a number of other dwelling centers which started to flourish along the eastern part of the Adriatic Sea such as Shkodra, Rizoni, Ulqini, etc.

Lisi was shaped as a developed city by the time when the people finished with the security system around it by the

end of IV century or the beginning of III century B.C.

The protecting walls of Lisi were strong and gloriously raised and from this point of view we can say that Lisi was ranked among the first cities that were bigger and more protected than the rest of Illyria and that its fortifying system was probably the more powerful and stronger than that of Apollonia.

Lisi functions as a seaside city and at the same time as the harbor in the south of the state of Ardians. It was an important post for the Illyrian Navy, in the sudden attacks against the seaside cities of Adriatik, Ionian further into the depth of the Mediterranean. The city still continued to be an important center in the time of Queen Teuta rule, who according

to the historic resources managed to organize the shipping fleet better and intervene more often with the navy in fulfillment of attacking other cities of Greece. The Lisi city and its fortification Akrolisi are mentioned for the first time in the historic resources of Polibi, Greek historian of the II century B.C who makes room in his translations for the roman Illyrian wars and the events that took place in the Illyrian land during the roman Macedonian wars during 246-146 B.C.

The city of Liss continues to be mentioned by Polibi, this time as a residence of Gent, the Illyrian King. In this fortified city Gent welcomed the first Macedonian delegation sent by Perseu with the purpose of creating an alliance between the two parties. The talks lasted for a




Por këto bisedime, siç dihet, u zgjatën me kthim e dërgim delegacionesh, derisa përfunduan në qytetin Meteon të Labeatisë. Marrëveshja u arrit dhe Genti dërgoi përfaqësuesit e tij së bashku me atë të Perseut në ishullin e Rodit, për një aleancë tripalëshe kundër Romës. Dhe sipas kronikave, Genti i pozicionuar në luftë të hapur kundër romakëve, mbledhi në qytetin e Lisit 15000 luftëtarë. Një njësi luftarake prej 1000 këmbësorësh dhe 50 kalorësish të kryesuar nga i vëllai, e nisi për të nënshtruar fisin e kavëve. Ndërsa vetë u nis kundër qytetit Basanie(5 milje larg Lisit) i cili asokohe ishte aleat i romakëve. Këto veprime të Gentit patën një kundërveprim të fuqishëm të romakëve dhe në luftën iliro-romake caktohen 11 porta(të mëdha e të vogla) që lejonin hyrjen në të gjitha drejtimet. Prej tyre 2 janë në anën e

sipërme, 6 në të mesmen dhe 3 në anën e poshtme. Në pjesën e sipërme porta kryesore ka qenë në anën lindore për të komunikuar me Akropolin, e dyta në anën veriore që e lidhte qytetin me zonën fushore. Ajo më e madhja ishte portë me një hapësirë drite 4,2 m dhe me një zgjidhje planimetrike krejt të veçantë në krahasim me tjerat. Zgjidhja e tyre arkitektonike dhe funksionet përkatëse janë përshtatur me terrenin.

Brenda qytetit të Lezhës ruhet rrjeti i rrugëve të cilat kryqëzoheshin në brëndësi. Nga të jashtmet që hyjnë në qytet janë tri : ajo që vinte nga jugu, një nga veriu dhe një tjetër nga verilindja. Skema e mureve mbrojtëse përfshin një gjatësi 2600 m, ku Akropoli, pjesa e sipërme është pjesa më speciale e fortifikimit. Muret përbëjnë dy stile

ndërtimi, i përkasin një faze kohore të lidhura këto me veçoritë stilistike morfologjike të mureve iliro-epirote. Nga një përlllogaritje e thjeshtë mendohet të janë mbi 80.000 copë blloqe të latuar me afro 100.000 m³ gur. E thënë pa frikë:një monument blloqesh guri ciklopikë, një vepër ndërtimore inxhinierike ndoshta e pashembullt në mbarë trojet shqiptare.

Me 168 para Krishtit, mbas pushtimit romak të Ilirisë së jugut qyteti vazhdon të ruajë rëndësinë e vet si qendër ushtarake e administrative dhe si bazë detare në Adriatikun verior. Pati disa rindërtime të qytetit ilir, sidomos në Akropol dhe anën e poshtme e limanin e lumit. Në zonën kodrinore ku qenë vendosur kolonët romakë janë gjetur edhe gërmadha të banesave të tyre prej guri. Janë zbuluar



- 05.** Portë kryesore e qytetit antik të Lissit
Main gate of ancient city of Lissi
- 06.** Mure te qytetit antik të Lissit
Antique walls of Lissi city
- 07.** Mbeturina nga shkrirja e metaleve, Konaj- Fant
Remains from the metal melting, Konaj- Fan
- 08.** Stoli ilire
Illyrian ornaments

long time and delegations kept going and coming until they ended up in the Macedonian city of Labeati. The agreement was reached and Gent sent his and Perseu's representatives to the island of Rhodes to reach a threefold alliance against Rome. According to the chronicles of the time, Gent positioned in an open war against the Romans gathered 1500 warriors in Lissi city. A war unit of 1000 infantry and 50 cavalry led by his brother were sent to subdue the Kava tribe. He was headed towards Basanie city (5 miles away from Lisi) which at that time was an alley of the Romans. Such acts were strongly reacted by the Romans and in the Roman -Illyrian war, there were assigned 11 gates (big and small) which allowed entrance from all directions. Two of them are on the upper side, 6 on the medium and 3 on the

bottom side. On the upper part the main gate used to be on the eastern side to enable communication with Akropoli, the second on the northern side which connected the city with the lowland area. The biggest gate was 4.2 m opened for light and a very specific planning solution. Their architectonic solution and the respective functions were adopted with the territory.

On the hilly side where the roman colons used to live, have been found ruins of stone habitations. There are also two inscriptions in Latin language which speak of the partial reconstruction of the city. It seems the roman reconstruction of the wall it results to have been done 250 years after the Illyrian fortifications. Even in the first centuries A.D, Lezha continued to be a center of civilization, being

an administrative part of Preval province with its center in Shkoder. Its recovery started at the beginning of VI century, where the castle of Lezha was in the list of the great reconstructions of the emperor Justinian the Great, through which the byzantine city of Lezha entered the list of the biggest centers of the era. The distinguished historian known by the Anonymous of Ravenna in the VII-VIII-centuries, mentioned Lezha as a seaside city. It matches with the time when the process of transformation of Illyrians into early Arbers, is also proved through the archaeological evidence of an Arber graveyard which was discovered in Qafë Kala. Upon the capitulation of Lezha city in the hands of the Republic of Venice by Progon Dukagjini, the city was incorporated into the Venetian state until the death of Gjergj Kastrioti.



edhe dy mbishkrime në gjuhën latine, që flasin për këtë rindërtim të pjesshëm të qytetit. Me sa duket, rindërtimi romak i mureve rezulton të jetë bërë rreth 250 vjet pas fortifikimit ilir.

Edhe në shekujt e parë pas Krishtit, Lezha do të vazhdojë të mbetet një qendër qytetare, administrativisht pjesë e provincës së Prevalit me qendër Shkodrën dhe një rimëkëmbje e saj do të nisë në fillim të shek.VI, ku kështjella e Lezhës do të ishte në listën e rindërtimeve të mëdha të perandorit Justiniani i Madh, rindërtime nëpërmjet të cilave qyteti bizantin i Lezhës do të hynte në qendrat më të mëdha të kohës. Kronikani i njohur si Anonimi i Ravenës në shekujt VII-VIII-të, do ta përmendë Lezhën si qytet bregdetar. Koha në të cilin ndodhi procesi i transformimit të

ilirëve të lashtë në arbërit e hershëm, fakt i cili vërtetohet edhe nga materiali arkeologjik i një varreze arbnore zbuluar në Qafën e Kalasë. Pas dorëzimit të qytetit të Lezhës Republikës së Venedikut nga Progon Dukagjini, qyteti përjeton përfshirjen në shtetin venedikas, i cili do të vijojë pa ndërprerje deri në vdekjen e Gjergj Kastriotit.

Banorët e hershëm të Mirditës kanë qenë Pirustët. Njiheshin si nxjerrës e përpunues të mirë të metaleve të bakrit, arit e argjendit.

Gjurmë të shkrirjes e përpunimit të metaleve datojnë që në shek. e I para Krishtit, aq sa perandori romak Trajan i pati dërguar si mjeshtra në minierat e Dakisë. Pirustët njihen si luftëtarë e strategj të përmendur kundër pushtimit

romak në vitin 54 para kr. dhe në shekujt VI-IX. Duhet theksuar se që nga neoliti i vonë e deri në periudhën e hekurit, ka vijë mësi të jetës në Mirditë. Monumentet arkeologjike i përkasin kryesisht mesjetës së hershme. Për këtë dëshmojnë në mënyrë të veçantë një numër varrezash të shtrira thuajse në të gjithë territorin si në: Përlat, Bukmirë, Kaçinar, Bukël e Prosek.

Ndër objektet e zbuluara si më të rëndësishmet vlerësohen stolitë, armët dhe veglat e punës etj. Të përmendura kanë qenë katër kuvendet benediktine dhe abacitë në Orosh, Shpal, Rubik e Ndërfanë, të dokumentuara që në shekullin e XII-të.

STEMA E ARBËRIT. Principata e Arbërit (1190-1216), formacioni më i



09. Armë dhe vegla pune Weapons and working tools

The early inhabitants of Mirdita were the Pirusts who were known for skilled workers of the metals like copper, gold and silver.

Traces of melting and processing of metals date back to I century B.C and they were so skilled that the roman emperor Trajan sent them as great masters in the mines of Dakia. The Pirusts are known as great strategs and warriors against the roman invasion in 54 B.C and during VI-IX centuries. It is worth emphasizing the fact that since the late Neolyth until the Iron Era there is a continuum of life in Mirdita. The archaeological monuments belong mainly to the early Middle Ages. A number of graveyards stretched almost all over the territory of: Përlat, Bukmirë, Kaçinar, Bukël e Prosek is good evidence.

Among the discovered objects the most important objects are ranked ornaments, jewelry, weapons and working tools, etc.. Also the four benediction conventions and the abbacies in Orosh, Shpal, Rubik and Ndërfanë, have been mentioned and documented since XII-century.

The EMBLEM of ARBËR. The Princedom of Arbër (1190-1216), the earliest state structure in Albania. It belongs to the Middle Age Period. The episkopal and administrative center of Arbëri Princedom was in Krujë. The Emblem of panhipersevas dates the original emblem of the prince families and one of the earliest ones in the European emblems. The emblem is found carved in stone in the exterior walls of Ndërfandi (Ndërfanë) church, in Gëziq of Mirdita. It

is comprised of Latin inscriptions which make mention of names of princes of Arbëri, Progoni and Dhimitri. Kruja has submitted many times grave disasters. Hence we can not be sure whether the emblem and the inscriptions were carved precisely for this church or were taken there for safety reasons.


The time of chasing these inscriptions dates back to the period of ruling of panhipersevas and of the great arhond, Dhimitri of Arbër (1208-1216), who was called by the Pope Inocenti IIIrd, as "Arbanesi principi" (the prince of the Arbër). The emblem is thought to have been of blue background with a golden eagle and open wings.

The EMBLEMA of SKURAJ. The Door of Skuraj is mentioned in the

10



10



hershëm në Shqipëri. I përket periudhës së mesjetës. Qendra administrative dhe peshkopale e principatës së Arbërit ishte në Krujë. Stema e panhipersevastit të Arbërit daton stemën më të hershme (të familjeve princore) dhe një prej me të hershmeve në stemografinë evropiane. Stema është gjendur në gurë të skalitur në muret e jashtme të kishës së Ndërfandisë(Ndërfanës), në Gëziq të Mirditës. Përbëhet prej mbishkrimesh në latinisht ku përmenden edhe emra prijësish të Arbërisë, Progoni dhe Dhimitri. Kruja gjatë historisë ka pësuar disa herë shkatërrime të rënda. Kështu, nuk mund të thuhet me siguri nëse stema dhe mbishkrimet u gdhendën enkas për këtë kishë, apo u sollën aty për t'u mbrojtur.

Koha e skalitjes së stemës e mbishkrimeve duhet kërkuar në

periudhën e sundimit të panhipersevastit dhe arhondit të madh, Dhimitrit të arbërit(1208-1216), të cilin Papa Inoçenti i III-të, do t'a quante "Arbanesi princi"(princi i arbëreshëve). Stema mendohet të ketë qenë e kaltër, me një shkabë t'argjendtë e flatrat e hapura.

EMBLEMA E SKURAJVE. Dera e Skurajve përmendet në dokumenta që në vitin 1274 (akte et diplomata I.133). Përmenden tre vëllezër: i pari Maurus Skura, i cili mban titullin sevast dhe Zakari e Gjergj Skura. Po në këtë vit njihim edhe një tjetër skuraj, Dhimitrin. Duke gjykuar nga dokumentet, përcaktohet se zotërimet e tyre shtriheshin nga fshati Skuraj i Kurbinit në zonën poshtë lumit të Matit e deri tek lumi i Drojës dhe më gjërë.

Në vitin 1304 Filipi, princi i Torantos iu njeh skurajve privilegjet e vjetra. Në vitin 1401 njihim Kostandin Skurën, dhëndër i Karlit i Topia. Në Lezhë, në kishën e Dom Lleshit , është zbuluar varri i Anton (Ndue) Skurës, nga i cili kemi edhe emblemën të gdhendur në gur sipas modelit venecian, çka flet se skurajt kanë bashkëpunuar me Venedikun. Pas motit të madh të Arbërit nga kjo derë në Kurbin njihim edhe Fusha Skurin e Pjetër Skurin. Në vitin 1981 stema e skurajve u muar nga muzeu i Lezhës dhe është vendosur në një prej mjediseve të muzeut historik kombëtar.

STEMA E LEZHËS. Mbështetet në një vulë të bashkësisë së Lezhës, përdorur në shekullin e XVI-të. Ajo na vjen pjesërisht e përshkruar. Stema ka figurën e Shën Gjergjit, shenjtit mbrojtës



10. Qeramikë, shekulli i parë
Ceramics, first century

documents since 1274 (akte et diploma I.133). Three brothers are mentioned in the documents of the time: the first of them was Maurus Skura, who held the title of sevast and Zakari and Gjergj Skura. Precisely in this year we get to know another from the Skuraj clan, Dhimitri. As seen from the documents of the time their tenures stretched from the village of Skuraj in Kurbin in the lower part of Mati River up to Droja river and wider.

In 1304 Filip, the prince of Torantos acknowledges the rights and privileges to the Skuraj family. In 1401 Kostandin Skuraj becomes a son –in- law to Karl Topia. In Lezha, precisely in the church of Dom Lleshi, is discovered the grave of Anton (Ndue) Skura, from who we inherit the stone carved emblem according to

the venetian model, which testifies that the Skuraj had cooperations with Venice. After the great year of Arbër we get to know more Skuraj from Kurbin such as Fusha Skuraj and Pjetër Skuraj. In 1981 the 9th emblem of the Skuraj family was taken from the museum in Lezha to the National Historic Museum premises.

LEZHA Emblem. It is based on the seal of Lezha communion and it was used in the XVI century. It comes to our hands partly described and has the face of St, Gjergj, the protecting saint of the city dressed in silver clothes. He appears wearing a red mantel and an areol around his head. St. Gjergj mounting a horse is aiming at a green dragon. The presence of this emblem is proved in 1578 when the elder leaders seal chancery documentation.

"...noi vechi di Alessio la sigilliamo con el nostro solito et consueto sigillo di messer san Zorzi, nostro confallone" which means: "...we the elderly of Lezha seal with our usual seal of St. Gjergj, our patron". In an anonymous report, the document of 1595, this anonymous person admits to have seen the seal himself and it writes: "...the seal with a stamp of St. Gjergj, with letters around which says, "The seal of Lezha communion..."

In the middle of XIV century Lezha wins autonomy and became urban commune similar to the type of Republic of Raguzës. In this period of time the city is completed with its legislative and juridical organs. Above central power was a count.

Kurbini was mentioned since XIV century by the name Korvin, Korbin. An early

11



KISHA NE RUBIK/MBISIMENT KULTURË

të qytetit, veshur me petka të argjendta. Krahëve mban një pelerinë të kuqe, rreth kokës një aureolë. Shën Gjergji hipur mbi kalë qëllon me heshtë një dragua të blertë. Qenja e kësaj steme vërehet kur më 1578 pleqësia e Lezhës vulos dokumentat kancelerike.

“...noi vechi di Alessio la sigilliamo con el nostro solito et consueto sigillo di messer san Zorzi, nostro confallone” që do të thotë: “...ne pleqtë e Lezhës po vulosim me vulën e zakonshme tonën të zotit shën Gjergji, pajtorit tonë”. Në një raport anonim, dokument i vitit 1595, anonimi shprehet se e ka parë vetë vulën ku shkruhet: “...vula me një stampim të shën Gjergjit, me shkronja përreth që thonë, “vula e bashkësisë së Lezhës...”

Në mesin e shekullit XIV Lezha fiton autonominë, duke u bërë komunë qytetare e tipit të republikës së Raguzës. Në këtë periudhë qyteti pajiset me organet e veta legjislative dhe gjyqësore. Në krye të pushtetit qëndror qëndronte një kont (comes).

Kurbini përmendet që në shekullin e XIV me emrin Korvin, Korbin. Qendër e hershme historike e Kurbinit ishte Delbnishti. Me krijimin e bajraqeve u bë bajrak më vete me qëndër Skuraj. Ndërkohë bëhet fjalë edhe për një qytet të lashtë me emrin Divast (afërsisht aty ku gjendet Laçi i sotëm) që shtrihej nga deti Adriatik, deri në kalanë e Sebastes.

Ekonomia mbështetej kryesisht në blegtori, sot është e zhvilluar edhe bujqësia.

12



KISHA NE GEZIQ

Jeta qytetare do të vazhdojë në Lezhë edhe në mesjetën e hershme. Pushtohet nga sllavët, bie nën sundimin e anzhuinëve, përfshihet nën zotërimet e Blinishtëve dhe të Balshajve. Në shek e IV, në kodrën mbi muret e Akropolit ndërtohet kështjella mesjetare dhe deri në 1393 Lezha ishte nën sundimin e dukagjinëve e më pas të venedikasve. Me 1478 pushtohet nga osmanët. Në rrenojat e mbetura një sy i sprovuar dallon lehtë edhe sot periudhat ndërtimore ilire, romake, veneciane e osmane.

Më 2 Mars 1444 u mbledh Kuvendi i Lezhës në të cilin Skënderbeu bashkoi princat shqiptarë. Edhe pas vdekjes së tij pati luftra dhe përpjekje të banorëve të Lezhës, Mirditës e Kurbinit kundër sundimit osman, në shekujt XV-XVII-

13



11. Kisha e Rubikut,
e dokumentuar që në shek XII
The church in Rubik,
documented since XII century
12. Kisha e Nderfanës
The church of Nderfanë
13. Abacia e Oroshit
The abbacy in Orosh

historic center of Kurbin was Delbnishti. By the time the flags were established Skuraj became the center of the flag. In the meantime another ancient city comes up in the documentation of the time with the name Divast (where actually Laç is) that stretched from the Adriatic Sea to the Sebaste castle.

The economy mainly was based on the livestock while nowadays agriculture is developed.

Urban life continued in the medieval period. It was invaded by the Slavs, falls under the rule of Anjuins, falls under the tenures of Blinishti and of Balsha. In the IV century, by that time up the hill and over the Akropoli was built with the characteristics of a medieval castle and until 1393 Lezha was under the rule of

the Dukagjini and later of the Venetians. In 1478 it was invaded by the Ottomans. An experienced eye can tell very easily the Illyrian, the Roman, Venetian and Ottoman construction periods even nowadays.

On March 2nd 1444 Lezha Convention was called in which Skënderbeg united the Albanian princes. Even after his death the citizens of Lezha, Mirdita and Kurbin, fought against the Ottoman rule during XV-XVII-centuries. Nowadays the Cathedral of Shënkoll, which is also the graveyard of our prince Gjergj Kastrioti in 1468, is turned into the Memorial of our National Hero.

The name Mirditë is mentioned for the

first time in the XV century. Among the valuable discoveries is the "Emblem of Arbër" and the epigraphic inscription found in Gëziq, in the ruins of the old church of Ndërfanë. These data illuminate sufficiently on the epicenter of the State of Arbërit and its princes. In the end of the XIII-century Mirdita was part of the territories of Dukagjin and the Canon of Lekë Dukagjini acted the same as in other northern parts. For centuries Mirdita was a self-administrative center. There were 12 flags and it was led by the elderly leaders, the flag leaders and the family of Gjonmarku. The Mirdita people are mentioned for a series of uprisings against the Ottoman invasion. This is also testified by the league of Mirdita in 1570, the uprisings of 1862 and 1876. The traditional conventions were held at the "Lisat e Shpalit" (the Shpali Oaks),



të. Sot katedralja e Shënkollit ku me 1468 është varrosur Gjergj Kastrioti, është kthyer në Memorial të Heroit tonë Kombëtar.

Për të parën herë emri Mirditë përmendet në shekullin e XV. Ndër zbulimet me vlerë është "Stema e Arbërit" dhe mbishkrimi epigrafik gjetur në Gëziq, në rrënojat e kishës së vjetër të Ndërfanës. Këto fakte hedhin dritë të mjaftueshme mbi epiqendrën e shtetit të Arbërit dhe princët e tij. Në shekullin XIII-të, Mirdita përfshihej në territoret e dukagjinëve dhe kanuni i Lekë Dukagjinit vepronte ashtu si në zonat e tjera veriore. Prej shekujsh Mirdita është vetëqeverisur. Kishte 12 bajrakë dhe prihej nga krerët (pleqtë), bajraktarët dhe dera e Gjonmarkut. Mirditasit përmendën për një varg kryengritjesh

kundër pushtimit osman. Këtë e dëshmon lidhja e Mirditës e vitit 1570, kryengritjet e viteve 1862 dhe 1876. Kuvendet tradicionale janë mbajtur tek "Lisat e Shpalit". Aty vendosej për çështjet më të rëndësishme. Përmenden kuvendi i Mirditës i vitit 1570, i Ndërfanës më 1595, i Dukagjinit (Orosh) më 1602, i Blinishtit për pajtimin e gjaqeve më 1944. Qëndresa me armë dhe diplomacia bënë që popullsia e kësaj treve të ruante besimin, identitetin kulturor dhe të siguronte një farë autonomie, e cila herë pas here ishte njohur dhe mbështetur edhe prej fuqive evropiane si Franca e Austria.

Si qendër e Kurbinit përmenden Skurajt. I banuar që në mesjetën e hershme vendosur në të dy anët e lumit Mat, bajraku përbëhej prej 16 fshatrave.

Vepronte kanuni i Skënderbegut dhe mbahej kuvendi krahinor. Banesa ishte e tipit kullë, e ngjashme me atë të Mirditës e të Matit. Njihen tri kala mesjetare: e Shkopetit, e Daules dhe Sebases. Në Skuraj zhvillohej një pazar i gjërë. Miloti ishte gjithashtu një qendër e hershme mesjetare e krahinës së Kurbinit, i cili përmendet që në vitin 1431. Përveç banorëve vendas në territoret kurbinase me kohë janë vendosur edhe mirditorë, malësorë të Malësisë së Madhe dhe kosovarë.

Kuvendi i Lezhës u mbajt në katedralen e Shënkollit. Në të morën pjesë udhëheqës të kryengritjeve të mëparshme antiosmane si dhe pjestarë të tjerë të aristokracisë shqiptare, midis të cilëve: Skënderbeu, Gjergj Arianiti, Andrea Topia, Gjergj Stres Balsha,



16



15

- 14.** Stema e Shtetit të Arbërit dhe mbishkrimi epigrafik i Gëziqit-Ndërfanë, 1190-1216.
The Emblem of the Arber state and the epigraphic inscription of Gëziq-Ndërfanë, 1190-1216.
- 15.** Gurë epigrafik të gjetur në Gëziq
Epigraphic stones found in Gëziq
- 16.** Emblema e Skurajve
The emblema of Skuraj

where the important decisions were made.

The documents make mention of the convention of Mirdita in 1570, Ndërfana convention in 1595, Dukagjini convention (Orosh) in 1602, the Blinishti convention for the reconciliation of blood feuds in 1944. Armed resistance and diplomacy were the only factors that the population of this area preserve faith, cultural identity, and ensure a certain autonomy which time after time was known and supported by European powerful countries like France and Austria.

Skuraj is mentioned as the center of Kurbini which was inhabited since early Middle Ages located on both sides of the Mati River and the flag was comprised of 16 villages. In this flag people lived their

life according to the Canon of Scanderbeg and regional conventions were held regularly. The dwelling places were like towers similar to the ones in Mirdita and Mati. There are three medieval castles known in the whole country: Shkopeti, Daule and of Sebaste. In Skuraj the bazaar had a lot of diversity. As well Milot was an early medieval center of Kurbini region which is mentioned in 1431. Besides the native inhabitants with time a lot of other people from Mirdita, Kosovo and Malesi e Madhe have become citizens of Lezha.

The Convention of Lezha was held in the Cathedral of Shënkolli. Many leaders of former anti ottoman uprisings, and other participants of Albanian aristocracy among them: Scanderbeg, Gjergj Arinoti, Andrea Topia, Gjergj Stres Balsha,

Nikoll and Pal Dukagjini, Pjetër Spani, Lekë Zaharia, Teodor Muzaka, Zaharia Gropa, Lekë Dushmani, Stefan Gjurashi were part of this convention. There were also representatives from Venice. The convention decided that the unity of the Albanians should be done in the form of a league of faith and trust among the leaders of the domains and other representatives of the nobility from all over the country, was then known as the Albanian League of Faith of Lezha.

It was a political and military alliance the chairman of which was elected Scanderbeg while the highest decision making organ was the assembly of members of the League, which would be summoned time after time on important issues. Another decision was the creation of the joint army and appointment of



17



18



19

Nikoll e Pal Dukagjini, Pjetër Spani, Lekë Zaharia, Teodor Muzaka, Zaharia Gropa, Lekë Dushmani, Stefan Gjurashi. Edhe Venediku dërgoi përfaqësuesin e vet. Kuvendi vendosi që bashkimi i shqiptarëve të bëhej në formën e një Besëlidhjeje ndërmjet drejtuesve të zotërimeve të lira dhe fisnikëve të tjerë të vendit që u njoh me emrin "Besëlidhja shqiptare e Lezhës".

Ajo ishte një aleancë politike e ushtarake. Kryetar u zgjodh Skënderbeu, kurse institucioni më i lartë vendimmarrës u bë Kuvendi i anëtarëve të Besëlidhjes, i cili do të mbledhej herë pas here për çështje të rëndësishme. Vendim tjetër ishte krijimi i ushtrisë së përbashkët dhe caktimi i Skënderbeut komandant i përgjithshëm i saj.

Ushtria e Besëlidhjes përbëhej nga dy pjesë: nga forcat e përhershme dhe prej atyre të përkohëshme që mobilizoheshin vetëm në rast luftime. Në ushtrinë e përkohëshme përfshiheshin të gjithë banorët e viseve të lira që ishin në gjendje të përdornin armët. Në rast nevojë ushtria e përbashkët mbronte vendin nga pushtuesit osmanë e veprimet armiqësore të vendeve të tjera, si dhe interesat e zotërimit e secilit anëtar të Besëlidhjes.

Për të përballuar shpenzimet e mbrojtjes së ushtrisë, të armatimit të saj etj, kuvendi vendosi që pranë Skënderbeut të krijoheshin një arkë e përbashkët. Fondet monetare të saj do të formoheshin nga ndihmat në të holla që secili anëtar i besëlidhjes do të jepte sipas një kuote të caktuar nga kuvendi,

nga të ardhurat e kriporeve të Shënkollit që kishin kastrojt pranë grykëderdhjes së lumit Mat, nga taksat doganore si dhe nga tregtia e drithit dhe e metaleve. Anëtarët e besëlidhjes shqiptare synonin që në kuadrin e saj të ruanin autonominë e tyre dhe Skënderbeu si kryetar i saj, të mos ndërhynte në zotërimet e të tjerëve, por të ishte i "parë ndërmjet të barabartëve".

Secili prej anëtarëve të Besëlidhjes kishte trupa të veçanta për të mbrojtur zotërimet e interesat e veta dhe ruante të drejtën të kishte marrëdhënie vetjake me vende e forca të tjera politike jashtë Besëlidhjes. Realisht vendimet e kuvendit i dhanë Skënderbeut një pozitë të veçantë ndaj fisnikëve të tjerë shqiptarë dhe siç shprehej Gjon Muzaka, "në kushtet e rrezikut të pushtimit osman,



17. Stema e Lezhës, bazuar në përshkrimin e vitit 1578 dhe 1595
The emblem of Lezha, based on the description of 1578 and 1595.
18. Kalaja e Sebastes
Sebaste Castle
19. Pamje nga Pazari i Milotit
View from Miloti Bazaar
20. Pamje të kalasë sot
View from the castle today

Scanderbeg as its commander in chief.

The Covenant army consisted of two parts: permanent forces and the temporary ones which would be called in case of war. The permanent army included all the inhabitants of the free areas who knew how to use weapons. In case of need the joint army would fight against the ottoman invaders and would protect the country from hostile interests of other countries, and also protect the interests of domains of every member of the league. In order to cope with the expenses of the protection of the army and its armament, the convention decided to create a joint cashbox near the settlement of Scanderbeg. Its funds would be collected by The aid in cash from an assigned quota for every member, from the income of the saltworks in

Shënkoll, owned by the Kastrioti near the embouchure of Mati river, from the customs taxes and from the metal and corn market. The members of the league aimed to maintain their autonomy within the league and its leader, Scanderbeg not interfere in other members` domains and properties but keep the position of "the first among the equal".

Each of the members of the league had troops to protect their interests and domains and had the right to personal relations with other countries or other political forces out of the League frame. Actually the decisions of the convention gave Scanderbeg more specific position versus other Albanian nobles and as Gjon Muzaka would say "under the risk of being invaded by the ottomans they were all obliged to obey".

THE BATTLE OF ALBULENA started on September 24, 1457. It was the peak of heat when Scanderbeg army, rided down the hills of Tumenisht Mountain, with three formations accompanied by furious drums, assaulted the Turkish army which was quite incautious. Scuppered, the Turkish forces despite being in big numbers were defeated completely after many bloody fightings. It is said that the number of the killed warriors was 15-30 thousand. In the meantime it is said that among the Turkish prisoners who were 870 was also Hamza Kastrioti, one sanjak bey and 18 field officers. The number of the Albanian warriors killed was 240, no commanders. The Albanian warriors, who fell in the battlefield in Albulena (Ujëbardha), were buried in the yard of St. Marie Madalene cathedral in Shënmëri village around 3 km in the



22



21

ishin të detyruar t'i bindeshin të gjithë".

BETEJA E ALBULENËS filloi me 24 shtator 1457. Ushtria e Skënderbeut nga kodrat e malit Tumenisht në piskun e vapës kur ushtria turke qëndronte e shkujdesur, me tre formacione të shoqëruara nga buçitjet e daulleve që të kallnin tmerrin, nga kodrat sulmoi me furi kampin turk. Të kapur në befasi, forcat turke ndonëse kishin epërsi numerike të konsiderueshme, pas luftimesh të përgjakshme u shpartalluan plotësisht. Për numrin e të vrarëve thuhet se kanë qenë 15-30 mijë veta. Ndërsa për robërit turq thonë se ishin 870, ku midis atyre që u kapën ishte edhe Hamza Kastrioti, një sanxhakbej dhe 18 oficerë të lartë. Shqiptarët patën 240 të vrarë, pa asnjë komandant. Luftëtarët shqiptarë që ranë në fushën e betejës

së Albulenës (Ujëbardhës), u varro- sën në katedralen e shën Mërisë Madalenë në fshatin Shënmëri që ndodhej afër fushës së betejës, rreth 3 km në lindje të Mamurrasit. Historiografia e vlerëson këtë betejë si një ndër më të shkëlqyerat fitore që Skënderbeu korri gjatë gjithë luftrave që zhvilloi kundër invazioneve osmane.

Në gjysmën e dytë të shekullit të XIII-të, përmenden një seri familjesh feudale si:

BLINISHTËT: Njëra prej familjeve më të njohura në mesjetë dhe princat e përmendur të Arbërisë: Vlado, Guljelm (marshall i Arbërisë) dhe Kalojan Blinishti, të cilët përmenden në burimet e shkruara që në vitin 1274.

KASTRIOTËT: Përmenden në dokumentet historike që me 1368. Principata e Kastriotëve u përhap kryesisht në Shqipërinë qëndrore. Kulmin e lulëzimit të saj e pati në kohën e sundimit të princit Gjon Kastrioti. Principata në këtë periudhë u shtri në malësinë e Tiranës, Mat, Dibër, Lumë dhe Has. Qendrën politike dhe administrative e pati në Gur të Bardhë të Matit. Në vitin 1413 Gjon Kastriotit iu dha titulli "qytetar nderi" nga senati i Republikës së Venedikut. Kësaj familjeje do t'i përkasë më vonë Gjergj Kastrioti-Skënderbeu (1405-1468), shpallur "Heroi Kombëtar i shqiptarëve". Strateg, ushtarak dhe burrë shteti i shquar. Udhëhoqi luftrat e lavdishme kundër pushtimit osman. Një prej figurave më të shquara të kohës së shekullit të XV-të. I lindur në njërin prej familjeve më të

23



21. Brenda kalasë
Interior view of the castle
22. Kalaja e vizitueshme
për shumë turistë
The castle visited by
many tourists
23. Obelisku kushtuar Kuvendit të
Lezhës, 2 Mars 1444
The Obelisque dedicated to
Lezha Convention, 2 March
1444

vicinity of eastern Mamurras. Historiography estimates this battle as one of the most excellent victories of Scanderbeg wars against turkish invasions.

In the second half of the XIII-century is mentioned a number of feudal families such as:

The BLINISHTI: one of the most well-known families in Middle Ages with the eminent princes of Arbëria: Vlado, Guljelm (the marshal of Arbëria) and Kalojan Blinishti, who are mentioned in the written resources since 1274.

The KASTRIOTS: were mentioned in the historic documents since 1368. The Principdom of the Kastrioti was spread mainly in central Albania. The peak of prosperity for this principdom

was in the time of Gjon Kastrioti rule. During this period the principdom was expanded in the highlands of Tirana, Mati, Dibër, Lumë and Has. Its political and administrative center was in Gur Bardhë in Mati. In 1413 Gjon Kastrioti was entitled "Citizen of Honour" from the Senate of Venice Republic. Later Gjergj Kastrioti-Skënderbeu- Scanderbeg (1405-1468), proclaimed "National Hero of the Albanians" will belong to this family will. Strategist, military man, and remarkable statesman who led glorious wars against the ottoman invasion. One of the most eminent figures of the time in the XV century who was born in one of the most distinguished families of the medieval time in Albania, the Kastrioti Door, one of the most important principdoms of the time. He cooperated with the western diplomacies of the time

and had the support of the Pope and of Vatikan. He led the convention in Lezha in 1444. We also know that Scanderbeg knew five foreign languages.

The DUKAGJINI. A ruling feudal family of XIV-XV century. Its domain extended from upper Zadrime to Ndërfanë and in the junction of Drini i Zi with Drini i Bardhe Rivers. This region preserved the name of the owners down to our days (the region of Dukagjini, the Dukagjini plane). The contemporary resources describe them as vast areas with strong brave men with monuments of culture, neighbours with properties of Kastrioti. The emblem of the Dukagjini was a big white one headed eagle. The first known member of the family was a duke, Gjin Tanushi(1281). Lezha city also belonged to this family, precisely to Tanush Duk-



njohura shqiptare të mesjetës, derës së Kastriotëve, një prej principatave më të rëndësishme të asaj kohe. Bashkëpunoi me perëndimin, pati mbështetjen e Papës dhe të Vatikanit. Kryesoi Kuvendin e Lezhës me 1444. Dijmë se Skënderbeu zotëronte pesë gjuhë të huaja.

DUKAGJINËT. Familje sunduese feudale e shek.XIV-XV. Zotërimet e saj shtriheshin nga Zadrima e sipërme deri në Ndërfanë dhe në bashkimin e Drinit të Zi me të Bardhin. Në këtë trevë u ruajt edhe emri i zotëruesve deri në ditët tona (Krahina e Dukagjinit, Rrafshi i Dukagjinit). Burimet bashkëkohore i përshkruajnë këto vise si një krahinë të gjërë me burra trima e të fortë, me monumente kulture, fqinj me zotërimet e Kastriotëve. Stema e Dukagjinëve ishte një shqiponjë e bardhë njëkrenore. I pari

pjesëtar i njohur i familjes konsiderohet një dukë, Gjin Tanushi(1281). Këtyre u përkiste edhe qyteti i Lezhës, të cilin e kishte humbur Tanush Dukagjini me të vëllanë Progonin me 1393, duke ia lëshuar Venedikut. Përfaqësuesit kryesorë të dukagjinëve në shek e XV-të ishin Nikollë e Pal Dukagjini , të cilët morën pjesë në Lidhjen e Lezhës dhe udhëhoqën disa prej kryengritjeve antiosmane. Pas vdekjes së Kryezotit i biri i Palit, Lekë Dukagjini do të bëhej një nga figurat udhëheqëse të luftës kundër pushtimit turk. Është interesant fakti se për fillimet e derës së dukagjinëve, disa studiues pohojnë se ato janë shfaqur që në shek. e VII-të.

BARDHAJT: Familje e madhe. Për shumë kohë kishte nxjerrë klerikë të lartë e kapedanë. Përmendet fillimisht

Tozol Bardhi i cili nga viti 1594-1610 ishte ipeshkvi i Zadrimës. Kryesoi kuvendin e Zadrimës më 1598 dhe që ndër organizatorët kryesorë të kuvendit të Dukagjinit më 1602. Kur Gjergj Bardhi u bë arqipeshkëv i Tivarit, Frang Bardhi u shugurua ipeshkëv i Zadrimës. Informohemi se kjo familje krenohet edhe me burra tjerë të dëgjuar më vonë, ndër të cilët përmendim Preng dhe Pavël Bardhin.

FAMILJA ALBANI: Sipas disa burimeve, të parët e tyre janë regjistruar në Urbino nga Kel Laçi, emigruar nga Kurbinit në vitin 1664. Më pas do të vendosen në Romë me mbiemrin Albani dhe u bë një nga familjet më të njohura të kohës. Prej saj do të kemi Papa Klementin e XI-të (1649-1721). Ndoqi një politikë neutrale dhe të matur.



- 24.** Memoriali i Vendvarrimit të Gjergj Kastriotit- Skënderbeut dhe i Kuvendit të Lezhës
The Memorial of the Graveyard of Gjergj Kastrioti- Scanderbeg and of Lezha Convention
- 25.** 25 mburoja prej bronzi të cilat tregojnë 25 betejat kryesore të Skënderbeut
25 bronze shields which speak of 25 main battles of Scanderbeg

agjini and his brother Progoni who later in 1393 left the city in the hands of the Venetians. The main representatives of Dukagjini in the XV century were Nikollë and Pal Dukagjini, who participated in the League of Lezha and led some of the anti ottoman uprisings. After the death of the suzerain, the son of Pal, Lekë Dukagjini would become one of the leading figures of the wars against Turkish invasion. It is an interesting fact to know about the beginnings of Dukagjini family to have become part of the history in the VII-century.

The BARDHAJ: A great family. For a long time it produced clerics and chieftains. It is mentioned for the first time by Tozol Bardhi who during 1594-1610 was the bishop of Zadrime. He led the Zadrime convention in 1598 and

was among the main organizers of the Dukagjini Convention in 1602. When Gjergj Bardhi became archbishop of Tivar, Frang Bardhi was ordained bishop of Zadrime. We have information that this family took much pride with other men mentioned later in history among them Preng and Pavël Bardhi.

The ALBANI family: According some resources, the predecessors of the family were registered in Urbino by Kel Laçi, who emigrated from Kurbin in 1664. Later they were settled in Rome having the surname Albani and became one of the most well known families of the time. This family produced the Pope Klementin the XIth (1649-1721). He followed a discreet and neutral policy and is remembered as one of the reformers of Catholicism. He was distinguished for

his high morals and was an enemy of the vices of the society and nepotism. He also wrote in Albanian language. He initiated a big convention in January of 1703 in Mërq of Lezha which was called "The convention of Arbni", during which it was decided that all the religious services would be performed in Albanian language. The material of this convention was published also in Rome in Albanian Language in 1706, entitled "the Council of Arbni".

Seven cardinals descended from this family among who the most known was Aleksandër Albani, established a museum mansion which was later named after "Albani Villa". Aleksandër Albani is known as one of the first in Italy and in Europe who created the museum of the precious collections from the an-



Kujtohet si një prej reformatorëve të katolicizmit. Shquhej për një kod të lartë moral dhe ishte armik i shoqërisë së sëmurë dhe nepotizmit. Shkroi edhe në gjuhën shqipe. Në Janar të 1703 në Mërqi të Lezhës inspiroi një kuvend të madh i cili u quajt “Kuvendi i Arbnit”, ku u diskutua e u vendos që shërbesat fetare të kryheshin vetëm në gjuhën shqipe. Materiali i këtij Kuvendi u botua në Romë në gjuhën shqipe më 1706 , nën titullin “Koncili i Arbnit”.

Kësaj familjeje i përkasin edhe shtatë kardinalë, më i njohuri ndër të cilët Aleksandër Albani, i cili ngriti edhe vilën muze që më vonë mori emrin e familjes “Vila Albani”. Aleksandër Albani njihet si një ndër më të parët në Itali dhe në Evropë, që krijoi muzeun e koleksioneve të çmuara nga antikiteti

dhe arti bashkëkohor. Shumë nga veprat e “Vilës Albani” janë shpërndarë në disa nga muzetë më të njohur të Italisë e të botës(në Kapitol, Luvër, në kështjellën Uindsor të Anglisë,në SHBA etj.) Medaljet e mbledhura prej tij, përbëjnë bërthamën e koleksionit në muzeun e Vatikanit.

DERA PRINCËRORE. Me seli në Orosh, e quajtur “Dera e Gjomarkajve” ose ndryshe, “Kapidanët e Mirditës”. Zë fill para disa shekujsh. Mendohet të jetë e njëkohëshme me familje të tjera të mëdha e të njohura të Shqipërisë veriore. Për periudha të gjata kohe, bashkë me krerët e vendit, luajtën rol vetëqeverisës. Nga kjo familje përmenden: Gjon Marku(1700), Preng Lleshi(1756),Lleshi i Zi, Preng Markola, Bib Dodë Pasha (1820-1868). Preng Bib Doda(Pasha)

(1859-1919), u kthye nga internimi i gjatë turk më 1904. Pas Shpalljes së Pavarësisë Kombëtare zgjidhet zv/ Kryetar i qeverisë shqiptare. I fundmi i Kapidanëve ishte Mark Gjomarkaj.

PAVARËISA

Në vitet 1910-1912 rrethinat e Lezhës por edhe ato të Mirditës dhe Kurbinit, përfshihen gjallërisht në kryengritjen e armatosur antiosmane. Ka patur një sërë memorandumesh e kryengritjesh prej këtyre banorëve, të inkuadruara në lëvizjen shqiptare.Kërkesat ndaj diplomacisë evropiane bëhen gjithnjë e më të forta, për t’u shkëputur nga sundimi i huaj e për krijimin e shtetit shqiptar.Spikat besëlidhja ndërmjet bregamatasve, malësisë së Lezhës, Mirditës dhe Kthellës. Më 1912 popullsia



- 26.** Shpata dhe përkrenarja e Skënderbeut
The helmet and the sword held by Scanderbeg
- 27.** Besëlidhja e Lezhës - 2 Mars 1444
Lezha League of Faith - 2 March 1444

tiquity and contemporary art. Many of the works from "Albani Mansion" were distributed in the most familiar museums of Italy and world museums (in Capitol, Louvre, Windsor Castle in England, USA, etc). The medals collected by him comprise the nucleus of the collection in Vatican museum.

THE PRINCEDOM GATE with its seat in Orosh, was called "the Gate of the Gjomarkaj" otherwise "The Captains of Mirdita". It took place centuries ago, and is thought to be of the same time with other distinguished families in Northern Albania. For longer periods of time together with the heads of the country they played an important selfgoverning role. Some of the remarkable men from these families are: Gjon Marku(1700), Preng Lleshi(1756), Lleshi

i Zi, Preng Markola, Bib Dodë Pasha (1820-1868). Preng Bib Doda(Pasha) (1859-1919), returned from a long Turkish exile in 1904. After the proclamation of National Independence he was elected as the deputy head of the Albanian Government. The last of these captains was Mark Gjomarkaj.

THE INDEPENDENCE

During 1910-1912 Lezha, Mirdita and Kurbini suburbs were actively involved in the anti ottoman armed uprising. There were a series of memoranda and uprisings from these inhabitants framed in the Albanian movement. The requests for the European diplomacy become stronger and stronger in order to separate from the foreign rule and create the Albanian state. The solidarity amongst

the people of Lezha, Mirdita and Kthella is very conspicuous during this period. In 1912 the population of Lezha regions was a part of the general uprisings which was crowned with the raising of the flag in Lezha Castle. The flag was raised also in Milot, Rubik and Malaj (Kthellë). Special contribution in the national movement for independence was given by: mylord Nikollë Kaçorri, mylord Luigj Bumçi, father Pal Dodaj, Preng Doçi, Shtjefën Gjeçovi, Hafiz Ali Ulqinaku, Ambroz Marlaskaj etc, for the inspiration of uprisings, establishment of patriotic associations, cultivation of our national culture and school.

Mylord Nikollë Kaçorri. Was one of the leaders of the armed uprisings in Kurbini. He led conventions and discussions with representatives of the movement



e krahinave të Lezhës u bë pjesë e kryengritjeve të përgjithëshme, e cila u kurorëzua me ngritjen e flamurit në kalanë e Lezhës. Flamuri u ngrit edhe në Milot, Rubik e Malaj (Kthellë). Kontribut të veçantë në lëvizjen kombëtare për pavarësi kanë dhënë edhe: imzot Nikollë Kaçorri, imzot Luigj Bumçi, padër Pal Dodaj, Preng Doçi, Shtjefën Gjeçovi, Hafiz Ali Ulqinaku, Ambroz Marlaskaj etj, në frymëzimin e kryengritjeve, krijimin e shoqërive patriotike, lëvrimin e shkollës e kulturës sonë kombëtare.

Imzot Nikollë Kaçorri. Njëri prej udhëheqësve të kryengritjeve të armatosura në Kurbin. Kryeson kuvende e bisedime me përfaqësues të lëvizjes për pavarësi nga Kruja, Ishmi, Kthella, Mirdita, Lezha e Mati, me qëllim për t'a shtrirë lëvizjen në të gjithë

Shqipërinë. Në qeverinë e Vlorës më 1912 të kryesuar nga Ismail Qemali, Nikollë Kaçorri zgjidhet nënkryetar i saj.

Preng Marka Prenga. Kreu i bajrakut të Oroshit dhe të Mirditës. Në qershor të vitit 1912 në krye të luftëtarëve të Mirditës, së bashku me ata të Lurës, Lumës, Matit e Dibrës, mësyn Lezhën për t'a çliruar prej sundimtarëve turq. Arrijnë të marrin në dorë kalanë dhe krejt qytetin.

Vëllezërit Gjeto e Ded Coku: Udhëheqës dhe organizator të luftës së bregamatasve kundër pushtuesve osmanë për shpalljen e pavarësisë kombëtare. Gjeto Coku së bashku me krerët e tjerë të kryengritjes lezhjane, në ditët e para të dhjetorit 1912, ngriti flamurin në qendër të qytetit të Lezhës.

Kol Toma. Drejtues i bajrakut të Velës, ideator dhe organizator në luftat për pavarësi, pjesëmarrës në kuvendet e krahinave të tjera në zonat e Shqipërisë veriore.

Llesh Nik Daka: Bregamatasit, me 22 të qershorit 1912 u ndeshën tre herë radhazi me një taborr të forcave turke. Shtypi i kohës na bën të njohur përpjekjet që u bënë po atë ditë tek kulla e Llesh Nik Dakës. Kur komandanti turk i bëri thirrje Lleshit që t'ia dorëzonte kullën se do t'a linte të lirë së bashku me familjen, ai iu përgjigj: "Shqiptari s'e ka adet me i dorzue as armët, as kullën. Po deshte, hajde e merri vetë". Kulla s'u dorëzua as edhe kur muret filluan të çahen prej gjyles së topave, as



29



30

28. Kuvend ne Mirditë, 1914
Convention in Mirdita, 1914
29. Portret i Skënderbeut i shek. XV
Portrait of Scanderbeg of the XV
century
30. Skanderbeg – gravurë gjermane
e shek. XVII
Skanderbeg – german
engraving of the XVII century

for independence from Kruja, Ishmi, Kthella, Mirdita, Lezha and Mati, aiming to expand the movement all over Albania. Nikollë Kaçorri was elected vice chairman of 1912 Vlova Government led by Ismail Qemali.

Preng Marka Prenga. The head of Oroshi and Mirdita flag. In June 1912 he led the warriors from Mirdita, Lura, Luma, Mati and Dibra, to free Lezha from Turkish rulers and they managed to take the castle and the entire city.

Zef Kol Noka (Little Zefi) – warrior for national independence

Brothers Gjeto and Ded Coku: Leader and organizer of the war of Bregmatas people against the ottoman invaders for the proclamation of national independ-

ence. Gjeto Coku together with other heads of Lezha uprising in the first days of December 1912 raised the flag in the center of Lezha city.

Kol Toma. Leader of the Vela flag, creator and organizer of the wars for independence, and participant in the conventions of other regions and other parts of northern Albania Llesh Nik Daka: On 22 June 1912 the people from Mati River banks, for three times in a row fought with a battalion of the Turkish army. The press of the time acquaints us with the fightings that took place by the tower of Llesh Nik Daka. When the Turkish commander called Llesh to surrender in exchange to the liberty of his family, he responded that: "the Albanian is not used to surrender neither the weapons nor his home. So if you want

come and get them". The tower did not surrender even when the walls started to break from the cannon balls, nor when in the yard was performed the most bestial massacre: three year old son was stabbed by bayonete and two women were killed!

The echo of this battle was quickly spread. The newspaper "Liria e Shqipnisë" "the Freedom of Albania" of 26 August wrote "the highlanders of Bregu of Mata fought against a Turkish army and fought bravely. The fight lasted for".

The Austrian council in Shkodër wrote: "Yes, there are albanians just like in Scanderbeg's time". The press of the time called Llesh Nik Dakën "Leonidha of the Bregut të Matës", while their file was called "file of the Spartans". The



kur në oborrin e saj u krye masakra më çnjërëzore: mbi majën e bajonetave u ngul djali trevjeçar e u vranë dy gra të shtëpise !...

Jehona e kësaj beteje përhapet shpejt. Në gazetën "Liria e Shqipnisë" e 26 gushtit shkruhej "Malësorët e Bregut të Matës i dualën para një ushtrie turke e i vunë pushkën. Lufta zgjati".

Konsulli austriak në Shkodër shkruan: "Po ka shqiptarë si në kohën e Skanderbegut". Shtypi i kohës do t'a quante Llesh Nik Dakën "Leonidha i Bregut të Matës", ndërsa çetat e tyre "çeta spartanësh". Dhe lahuta e çiftelia do t'i këndonin: Llesh Nik Daka i zog petriti/shum' asqerin e ka pritë/ s'e din kush se sa ka mbytë...

Gjin Pjetër Përvizi i Skurajve: Patriot, jetoj mes viteve 1856-1914. Njëri prej njëjërëve të përmendur të asaj kohe. Udhëheqës popullor i krahinës së Kurbinit. Gjin Pjetri në vitet e para të shek.XX, fatet i lidhi më përkjekjet për pavarësinë kombëtare.

Midis dy luftave botërore Lezha dhe Mirdita ishin nënprefektura të Shkodrës. Kjo periudhë karakterizohet nga një zhvillim i ngadaltë ekonomik, me përjashtim të portit të Shëngjinit. Investimet e shoqërive italiane si në hapjen e rrugëve, shfrytëzimin e pyjeve dhe të mineraleve në Rubik etj, do t'u përkisnin viteve '30 të shekullit të kaluar.

Më 7 prill 1939 popullsia e rajonit nuk u pajtua me pushtimin fashist dhe mbështeti luftën nacional-çlirimtare. Më

1943 u krijua formacioni partizan, çeta Pukë-Mirditë. Janë zhvilluar disa luftime kundër forcave gjermane si në Gëziq etj.

Pas çlirimit Mirdita përmendet për zhvillimin e industrisë së bakrit, gjeologjinë dhe minierat. Laçi për industrinë e përpunimit të bakrit, drurit dhe prodhimit të superfosfatit. Kurse Lezha përveç bujqësisë pati të zhvilluar industrinë e lehtë, ushqimore dhe prodhimin e letrës. Në të gjithë rajonin ishin ngritur një numër ndërmarrjesh ekonomike, industriale e bujqësore, pyjeve e të transportit, rrugëve e urave, grumbullimit të bimëve medicinale, përpunimit të drurit dhe të makinave bujqësore. Shtrirje patën rrjeti tregtar, komunal dhe postë-telekomunikacionit.

32



33



34



- 31. Beteja e Albulenës- F.Haxhiu
The battle of Albulena- F.Haxhiu
- 32. Përkrenarja e Skënderbeut
The Helmet of Scanderbeg
- 33. Stema e Kastriotëve
The Emblem of Kastrioti
- 34. Emblema e Kastriotëve
The Emblem of Kastrioti

lute and the cifteli would play: Llesh Nik Daka like a hawk/ many enemies has fought/ that many no one knows

Gjin Pjetër Përvizi of Skuraj: A patriot who lived during 1856-1914. One of the most distinguished people of the time, who was also a popular leader of the Kurbini Region. Gjin Pjetri since the first years of the XX century fought for national independence.

In between the two world wars Lezha and Mirdita were sub-prefectures of Shkodra. This period is characterized by a slow economic development, with the exception of Shëngjini harbour. Investments made by Italian companies such as opening of roads, use of forests and minerals in Rubik etc, belonged to the '30ies of the past century.

On April 7, 1939 the population of the region did not agree with the fascist invasion and supported the national liberation war. In 1943 was created the first partisan formation, the u krijua formacioni partizan, the Pukë-Mirditë file. Some battles were fought against the Germans in Gëziq, and some other places, etc.

After the liberation of the country, Mirdita is mentioned for the development of copper industry, geology and the mines. Laçi is mentioned for the copper wood and superphosphate processing industry. Lezha on the other hand is known for agriculture and the light, food processing and paper producing industries. All over the region there were established a number of economic, industrial and agricultural, forest and

transportation, road and bridges, collection of medicinal herbs, wood processing and of agricultural machinery enterprises. As well trade, communal and post telecommunication services were in place all over the region.



35



36



37



40



41



42




45






38



39



43



44



46




47

35. Stema e Dukagjinëve
The emblem of Dukagjini
36. Princi - Lekë Dukagjini
The Prince - Lekë Dukagjini
37. Papa Klementi i XI-të
The Pope Klement the XI-th
38. Bibë Dodë Pasha
Bibë Dodë Pasha
39. Preng Bibë Doda (Pasha)
Preng Bibë Doda (Pasha)
40. Llesh Nik Daka
Llesh Nik Daka
41. Zef Kol Noka (Zefi i Vogël)– luftëtar
për pavarësi kombëtare
Zef Kol Noka (Little Zefi) – warrior for
national independence
42. Kol Toma i Velës
Kol Toma, Leader of Vela
43. Preng Marka Prenga
Preng Marka Prenga
44. Dom Nikollë Kaçorri
Mylord Nikollë Kaçorri
45. Ngritja e flamurit në Lezhë,
4 dhjetor 1912
Raising of the flag in Lezhë,
4 December 1912
46. Lezha në vitin 1914
Lezha in 1914
47. Gjin Pjetër Përvizi
Gjin Pjetër Përvizi

Etnokultura

03

Ethno culture



A reali etnokulturor i Qarkut të Lezhës shtrihet në një territor të vendosur në veriperëndim të Shqipërisë. Ky pozicion gjeografik ka qenë i favorshëm për t'iu ruajtur ndikimeve të kulturave të fqinjëve. I zhvilluar ndër breza visari i traditës popullore ka ruajtur identitetin nacional në të gjithë ndarjen konvencionale si kulturën materiale, kulturën shoqërore, kulturën artistike dhe shpirtërore, duke ruajtur në mënyrë konservative tiparet dalluese të njësisë nacionale dhe duke i dhënë asaj vlera unikalë si në fondin dokesor, letërsisë gojore dhe të folkut në tërësi.

Edhe në Qarkun e Lezhës, i cili rrok edhe rrethet e Mirditës e Kurbinit, dukuritë etnokulturore, të moçme a të evoluuara kanë mbijetuar se kanë kryer

disa funksione në jetën sociale të këtyre viseve, mandej në kushte të caktuara janë ripërtëritë e zgjeruar e kanë marrë përmasa të reja .

Etnokultura ekziston ndër kohëra me një larmi të madhe shfaqjesh sipas trevave e shtresave shoqërore, sipas llojit të urbanizimit ose të veçimit mes malesh. Ashtu siç ekziston dhe gjuha me dialekte e të folme të ndryshme, po ashtu shfaqen dhe dukuritë etnokulturore edhe në këto anë...

I kundruar në këtë rrafsh Qarku i Lezhës ka një atlas të larmë e të pasur etnokulturor.

Rrethi i Lezhës shpaloset me një larmi të madhe tiparesh etnokulturore, sepse lëvizjet historike demografike kanë sjellë

e formësuar një larmi kostumesh dhe këngësh, melodish, vallesh e rrëfimesh gojore e pse jo dhe vegla popullore, ku veçohet lahuta që ka shoqëruar këngët e Eposit të Kreshnikëve, duke e zgjeruar kështu gjeografinë e kësaj tradite të vyer.

Zadrima shfaqet e veçantë në kostumografi dhe në këngët e saj. Kallmeti është quajtur shpesh si zonë e ndërmjetme etnografike. Veshja e gruas kallmetore është mjaft e hershme, por dhe në këngët e dasmës ka elemente të veçantë ku identifikohet një fenomen fonetik si askund tjetër në veri. Metafoni kemi në këngën e njohur: "Ec kadalë e pesho randë". Malësorët e Malësisë së Madhe, me migrimet e tyre të vazhdueshme, sollën në Fushën e Lezhës kostumet ,meloditë e këngët e veta, ku krahas larmisë dhe diversitetit,



1. Atë Shtjefën Gjeçovi 1874-1929
Father Shtjefën Gjeçovi 1874-1929
2. Dom Frano Ilia 1918-1997
Dom Frano Ilia 1918-1997

The ethno culture areal of Lezha Region is extended all over the territory on the northwestern part of Albania. This geographical position was very convenient to be safe from the neighboring cultural influences. The treasure of folk and tradition has well preserved the national identity throughout conventional division into material culture, social culture, artistic and spiritual culture. In this way it has managed to preserve the distinguishing features of the national unit with unique values in the golden fund of mores, literature and folk in general.

Lezha Region which embraces the districts of Mirdita and Kurbini has survived some old or evolved ethno cultural phenomena because of other functions in the social life of these areas and under

certain conditions have grown into new sizes. Ethno culture lives through time in a variety of appearances according to social order, diverse areas, and according to urbanization or isolation among mountains. Ethno culture exists in these areas in the same way language exists in diverse dialects. In this point of view Lezha Region has a rich ethno cultural atlas, because the demographic movements have enriched it with a variety of costumes, songs, melodies, dances, tales and folk instruments (among which we can mention the lute which accompanied the songs of Epos valiant heroes, expanding the geography of this precious tradition.

Zadrime is particular for its songs and ethnic costumes. Kallmeti is called an intermediate ethnographic area. The

apparel of the woman from Kallmet dates back in early stages but also in the wedding songs there are special elements that identify a unique phonetic phenomenon all over the north of Albania. We come across met phony in the known song: "Walk slowly and with dignity". The highlanders of Malësi e Madhe, along with migration phenomenon brought their costumes, melodies and songs in the Field of Lezha, and in parallel with variety and diversity, ethno culture carried out its ethnic function. Today's Mirdita along with its ethno cultural features is distinguished for its conservative spirit in preservation of the mores, and folk culture in general. It is a compact region and less influenced by limited interregional relationships which is related not only to its relief but also to other features of historic, cultural and



etnokultura ka kryer funksionin e saj etnik.

Mirdita e sotme dhe ajo etnokulturore shquhet për frymën e saj konservatore në ruajtjen e dokeve dhe kulturës popullore në përgjithësi. Ajo është një krahinë kompakte dhe më pak e ndikuar nga marrëdhëniet e kufizuara ndërkrahinore që nuk lidhet vetëm me relievin e saj, por dhe me veçori të tjera të zhvillimit historik, kulturor e religjioz.

Nëse Lezha e Mirdita janë "Dheu i Kanunit" të Lekë Dukagjinit, Kurbini i përket hartës së kanunit të Skënderbeut. Kjo nuk do të thotë se dallimi është i dukshëm, pasi janë krahina kufitare dhe me densitet të lartë marrëdhëniesh e lidhjesh miqësore dhe ekonomike dhe se të dy kanunet janë pjesë e një trungu etnik.

Kostumet e grave me besim mysliman në Kurbini janë të ndryshme nga kostumet e tjera të Kurbinit, por dhe të rajonit. Të tilla janë dhe këngët në përgjithësi, por këngët e dasmës në veçanti.

Këngët e dasmës në trevat tona janë pasqyrim i plotë i riteve që zbatohen në dasmë. Veç këngëve tradicionale të ceremonialit, ku iu thuren lavde dy simboleve të dasmës, dhëndrit dhe nuses, këndohen edhe këngë patriotike, dashurie, trimërie, bahen hoka, etj. Këngët e dasmës janë një pasuri e çmuar e lirikës sonë popullore. Këta këngë, shpesh këndohen dhe përshtatet me çaste të caktuara të dasmës, si hapja e valleve, hapja e dasmës, pritja e nuses, momentit kur nusja del për të nusëruar, mbyllja e dasmës etj. Në këto

këngë shprehet hareja dhe gëzimi për formimin e një familje të re, dashuria dhe optimizmi për jetën. Vargjet thuren ose improvizohen me figura të thjeshta letrare, sidomos epiteti, ku nusja quhet qafëgastare, lule mali, thëllëzë, pëllumbeshë, zanë, dallëndyshe, ndërsa dhëndëri trim me fletë, yll, kapedan trim, dai etj.

Dhëndri dhe nusja krahasohen me diellin, dritën e hënës, yjet e qiellit, lulet e pranverës etj. Në këngë të tilla dominojnë figurat e zgjedhura dhe fjalët e kursyera si: "...Këndoi gjeli n'skaj t'zabelit, / na pru nusja çorapë telit, / çorapë telit ly me bojë, / dhanrri beg e nusja zojë...".

E pasur treva jonë është edhe në traditën e vajtimin. Vajtimi është konsideruar si një krijim spontan që ka



3. Sarajet e Derës princore te Gjomarkajve, Orosh.
The palaces of Gjomarkaj Princesdom in Orosh
4. Kulla katër katershe - Mirditë
The quadruple tower house in - Mirditë

religious development.

If Lezha and Mirditë are the Ground of the Canon of Lekë Dukagjini, then Kurbin belongs to the map of Scanderbeg's canon. This means that distinction is invisible as they are bordering regions with intensive relationships and friendly, economic relations and that both canons are part of the same ethnic stem. The women costumes of the Muslim religion in Kurbin are different from other costumes of Kurbin, and from those of the region. The women costumes of the Muslim religion are different not only in Kurbin area but also in the whole region. Even the songs are different in general in addition to the wedding songs in particular. The wedding songs in our areas are a full representation of the rituals of a wedding. Besides the traditional songs

of the ceremony by covering with praises to the two symbols; the groom and the bride, patriotic, love, bravery songs were also part of the repertoire of the wedding, as well as limericks. Wedding songs are a precious treasure of our folk lyrics and they are always sung during certain moments of the wedding such as the opening of the wedding, opening of the dances, welcome of the bride, the moment when the bride stays arm crossed, closing of the wedding, etc. These songs express gaiety and joy for the creation of a new family, love and optimism for life. The lines often go improvised with simple literary figures, especially the epithet, when the bride is described as a slender fair skin neck, or is compared to a mountain flower, or to a quail, or to a fairy, or even to a swallow, while the

groom is described as a valiant man, star, brave captain, and very generous and brave man, etc.

The groom and the bride are compared to the sun and the moonlight, the stars in the sky, the flowers in the spring, etc.

In such songs prevail selected figures and spare words such as: "the cock sang on the grove/the bride brought us wire socks/wire socks painted in paint/the groom as a bey; the bride as a lady..."

Our region is rich also in the tradition of wailing which was considered as a spontaneous creation in cases of misfortune, or loss of the relatives. In such cases deep grief prevails for the loss of their beloved. This feeling expressed through fatality and later through the wailing

5



6



lindur në raste fatkeqësish , humbje e të afërmit. Në raste të tilla mbizotëron dhembja e thellë për humbjen e njeriut të afërt. Kjo ndjenjë shprehej përmes gjamës dhe më pas përmes vajtojçës, shpesh nëpërmjet vargjeve spontane duke vënë në pah cilësitë fizike dhe morale të të vdekurit. Në trevat tona është përshtatur bukur mënyra e të vajtuarit ndryshe për një burrë, ndryshe për një grua, kjo përshtatur edhe sipas moshës, pozitës shoqërore dhe profesionit. Gjama në këto anë është praktikuar kryesisht nga burrat. Në mënyrë të vetvetishme dhe me mjete shprehëse figurative emocionale, duke thurur vaje të mrekullueshme për humbjen e njerëzve të dashur.


Qarku i Lezhës – Dheu i kanuneve

Kanuni i Lekë Dukagjinit ose Kanuni i maleve është përmbledhja e ligjeve, rregullave, zakoneve shqiptare në një libër, në rrjedhën e disa qindvjeçarëve, para dhe pas jetës së LEKË DUKAGJINIT, të cilit i mvishet autorësia e tij. Disa nga ligjet dhe normat kanunore janë trashëguar nga ILIRËT, pararendësit e shqiptarëve të sotëm.

Thelbi i Kanunit të Lekë Dukagjinit janë fjalët e urta të dala nga goja e tij, që u ruajtën dhe u pasuruan brez pas brezi për gati gjashtë shekuj. Ata janë përçuar gojarisht nga brezi në brez. Ligjet e "Kanunit" kanë shërbyer për shumë SHEKUJ si mënyra e themeltë e sjelljes

shoqërore dhe vetëqeverisjes për klanet e Shqipërisë së Veriut, edhe atëherë kur rajoni sundohej nga Osmanët. Rëndësia e Kanunit në historinë e popullit shqiptar mund të mbivlerësohet pak, por rregullat dhe normat e tij vazhdojnë ende të ushtrojnë një ndikim të ndjeshëm ndër shqiptarët. Kanunit i Lekë Dukagjinit u mblodh , u kodifikua dhe u pajis me shënime nga kleriku dijetar e atdhetar i shquar atë Shtjefën Gjeçovi dhe u botua me 1933 në Shkodër me një parathënie të At Gjergj Fishtës, ndërsa më 1972 u botua në Prishtinë me një studim hyrës të S.Pupovcit.

7



5. Kullë gjashtëkëndëshe – Kurbin
The hexagonal tower house in Kurbin
6. Kullë 3-katëshe- Malësi e Lezhës
The three floor tower house in Lezha
7. Dyer kullash të gdhendura në gur
Tower main doors carved in stone

women or men often with spontaneous words and lines added to point out the physical and moral features of the dead person. In our regions it is well adjusted the way of wailing differently for a man compared to the way of wailing for a woman in addition to the position, age, and profession of the dead person. Wail in these areas has been practised mainly by men in a very conscious way, using figurative emotional means thus by making wonderful lines for the loss of the beloved dead person.

Lezha Region –the ground of the canons

The Canon of Lekë Dukagjini. The canon of Lekë Dukagjini or the Canon of the Mountains, is a summary of the Albanian laws, customs and rules in a book, in the flow of some hundred years, before and after LEKË DUKAGJINI's life whose authorship it was dedicated. Some of the laws and canon norms were inherited by the Illyrians, the ancestors of Albanians nowadays. The backbone of the canon of Lekë Dukagjini is words of wisdom said by him which were preserved and were enriched and were handed down from generation to generation in almost 6 centuries. Such words of wisdom were transmitted from generation to generation. The laws of the "Canon" have served for many centuries

as the foundation manners of social behavior and self governance for the clans of Northern Albania, even when the region was ruled by the ottomans. The importance of the "Canon" in the history of the Albanian people could be a little over estimated but its rules and norms still impact deeply on the Albanians. The canon of Lekë Dukagjini was coded and was equipped with notes by the erudite cleric and ardent patriot Father Shtjefën Gjeçovi and was published in 1933 in Shkodër with a preview from Father Gjergj Fishta, while in 1972 it was published in Prishtinë previewed by S.Pupovci.



LIBER I SHSTATËT. FJALA E GOJËS. NYJE I TETËDHETEGJASHTËT.

Fjala.

"Fjala mort s'bân". – "Shtriga në gjak nuk bjen". – "Goja s'qe

§ 520. Giûha âsht tulit e gjithshka bluen.

§ 521. Fjala e gojës s'ême hîn në vesh të tjetrit, e i treti e perdoron për rrënim të kuej, un rrî e tallem.

§ 522. Fjala e ême në shkaktofët vrasë të përgjegjme un rrî e zgerdhîhem; nuk mund të më kapë kush për pûnë të liga, qi shkaktoi goja e ême.

§ 523. Aj, qi shkon tuj mjellë e tuj hapë fjalë të kqija e gergasa herë per njanin herë per tjetrin, me gojë të kanunit thirret »Argat i keq«. As e thrret kush në pûnë, as i nep kush rrogë.

§ 524. A fola a s'fola, goja nuk vulosë gjâ. - Fjalët e sterqgive kanûja s'i mërr para sysh.

Oroe: Shênjimim e fuqin e fjalës së folun në hov të vrasës e shka don me thânë »Fjala peng«, me kohë do të zhvillohen.

NYE I TETËDHETESHTATËT Mohi.

§ 525. Mohues thirret aj, i cilli nuk i vêhet zhgarkimit as shpifjes, kje per ndo'i dâm, per vjedhni aper ndo'i vrasë, etj.

§ 526. Të germushunat e kercnimet prej nij hamendje kanûja s'i bân. - Mohuesit nuk mund t'i hypet në qafë qi të lajë, pasë e pápasë, per çdo zhgarkim e shpifje.


§ 527. Mohuesi vetem atbotë bjen në faj, kúr ky mos të duej me ardhë n'arsye.

§ 528. Zhgarkuesi e shpifsi e bjen n'arsye mohuesin me pleq e me peng.

NYE I TETËDHETETETËT.

Beja.

"Pertë bén nuk shtýhet mllefi" 1



7. Varreza në fshatin Nënshejt.
Graveyard in Nenshejt village
8. Stola druri
Wood engraving
9. Karrige e nuses
The bridal chair
10. Djep
Cradle

BOOK SEVEN. THE WORD OF MOUTH. CHAPTER EIGHTY SIX

The word

The word does not bring death- the witches do not have blood feud- the mouth does not put someone in blood feud"

520. The tongue is from meat and grinds all kinds.

§ 521. The word comes out of my mouth into the ear of somebody else and the third person uses it (the word) to ruin somebody else and I stay and mock at others
Fjala e gojës s'ême hîn në vesh të tjetrit, e i treti e perdoron për rrënim të kuej, un rrî e tallem.

§ 522. Fjala e ême në shkaktofët vrasë të përgjegjme un rrî e zgerdhîhem; nuk mund të më kapë kush për pûnë të liga, qi shkaktoi goja e ême.

§ 523. Aj, qi shkon tuj mjellë e tuj hapë fjalë të kqija e gergasa herë per njanin herë per tjetrin, me gojë të kanunit thirret »Argat i keq«. As e thurret kush në pûnë, as i nep kush rrogë.

§ 524. A fola a s'fola, goja nuk vulosë gjâ. - Fjalët e sterkqive kanûja s'i mërr para sysh. Oroe: Shênjimin e fuqín e fjalës së folun në hov të vrasës e shka don me thânë »Fjala peng«, me kohë do të zhvillohen.

NYE I TETËDHETESHTATËT Mohi.

525. Mohues thirret aj, i cilli nuk i vëhet zhgarkimit as shpifjes, kje per ndo'i dâm, per vjedhni aper ndo'i vrasë, etj.

§ 526. Të germushunat e kercnimet prej nji hamendje kanûja s'i bán. - Mohuesit nuk mund t'i hypet në qafë qi të lajë, pasë e pá pasë, per çdo zhgarkim e shpifje.

§ 527. Mohuesi vetem atbotë bjen në faj, kúr ky mos të duej me ardhë n'arsye.

§ 528. Zhgarkuesi e shpifsi e bjen n'arsye mohuesin me pleq e me peng.

NYE I TETËDHETETETËT.

Beja.

"Pertë bén nuk shtýhet mllefi" 1

11



12



"Bé, e s'ka përtej".

"Beja lán gjaqe".

"Gjânë e djerrun e gjaqet e hupuna i vèn

"A bén, a gjân".²

§ 529. Beja është një sjellje besimtare, për mjet së cillës nieri, tuj dashtë me dalë së keq prej një zhgarkimi të dhûnshem, do të perkasë me dorë një shêj besimi, tuj e grishë êmnin e Perendís në dishmí të së vertetës.

§ 530. Kjo dorë beje është e pelqyeme prej kanunit të Malevet të Shqypnís si për të dliun prej zhgarkimesh, si edhe për të lidhun besë.

§ 531. Bén nëgojësh kanûja as s'e pelqen, as s'e tumirë; e për të dliun prej zhgarkimesh lypet doemòs qi të bâhet beja mbë një shêj besimi e të perkitet me dorë.

§ 532. Beja e Shqyptarit ká dý pûnë para sýsh: a) thrret Perendín në dishmí të së vertetës; b) i nenshtrohet randimit të ndeshkimevet të perjetshme e giobës së kohshme kah kanûja.

NYE I TETËDHETENANDËT.

Beja mbë "Gúr" e beja mbë Kryq e mb'Ungjill.

Një vepër me vlera është edhe Kanuni i Skënderbeut, mbledhë dhe kodifikuar nga dom Frano Ilia dhe botuar më 1993 në Bari. Është një vepër monumentale, që përmban një material të pasur, i cili ka rëndësi të shumëfishtë për studime shkencore jo vetëm në lëmin juridik, por edhe në disiplinat e tjera të shkencës. Kanuni i Skënderbeut nuk është vetëm një përmbledhje e thjeshtë e zakoneve, traditave dhe normave të rralla të një qytetërimi të caktuar, por edhe një vepër monumentale ku spikasin vlerat e larta etike dhe shoqërore në saj të të cilave shqiptari ka mbijetuar në shekujt e robërisë.

Kanuni i Skënderbeut vepronte edhe në shekullin XIX, për shembull në Malësinë e Dibrës, kemi dëshmi jo vetëm nga Hahn, por edhe nga konsulli rus, M.



13



14



11. Djep i trevës së Kurbinit
Cradle from Kurbin Area
12. Enë kuzhine
Kitchen dishes
13. Voze rakië
"raki" tank (alcoholic drink)
14. Shtama
Pitchers

"Bé, e s'ka përtej".

"Beja lán gjaqe".

"Gjânë e djerrun e gjaqet e hupuna i vèn per udhë beja".

"A bén, a gjân".2

